




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.53/24

Datë: 18.06.2024

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 18.06.2024, mori këtë;

VENDIM

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e aseteve mbi Euronickel Industry Doo dhe Nova Refraktori Doo Pehcevo (shoqëritë target). Komercijalna Banka AD Shkup (shitës) nga Kingman Refractories Dooel Shkup dhe Double Eagle Nickel Dooel Shkup shoqëri të grupit Yildirim International Investment Holding B.V., (blerësit).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 07.05.2024, me Nr. Prot. 71/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e aseteve mbi Euronickel Industry Doo dhe Nova Refraktori Doo Pehcevo (shoqëritë target). Komercijalna Banka AD Shkup (shitës) nga Kingman Refractories Dooel Shkup dhe Double Eagle Nickel Dooel Shkup, shoqëri të grupit Yildirim International Investment Holding B.V.,(blerësit).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 17.05.2024.
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 20.05.2024.
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshjet për blerjen e aseteve të lidhur ndërmjet, Yildirim International Investment Holding B.V., (blerës) dhe Komercijalna Banka AD Shkup (shitës) mbi Euronickel Industry Doo dhe Nova Refraktori Doo Pehcevo (targeti) të lidhur me datën 22.04.2024.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me 22.04.2024 e lidhur mes palave në Përqendrim.

Palët në Përqendrim:

Yildirim International Investment Holding B.V., është shoqëri private me përgjegjës të kufizuar e krijuar dhe e organizuar sipas ligjeve të Holandës, me selin e saj të korporatës në Amstelveen Holand dhe adresë të regjistruar në Prof.W.H. Keesomlaan 5, 7783 DJ Amstelveen Holand.

Për realizimin e këtij transaksioni janë themeluar dy shoqëri me qëllime të veçanta (SPV). Kingman Refractories Dooel Shkup dhe Double Eagle Nickel Dooel Shkup, këto kompani janë në pronësi indirekte nga Yildirim International Investment Holding B.V

Kingman Refractories Dooel Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me një anëtarë të inkorporuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me seli në bulevardin 8 Septemvri nr.16, kati 2/ Hyperium – Qendra e Biznesit, Shkup, Maqedonia e Veriut, i cili merret me aktivitetet si; prodhimi i produkteve zjarrduruese.

Double Eagle Nickel Dooel Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me një anëtarë të inkorporuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me seli në bulevardin 8 Septemvri nr.16, kati 2/ Hyperium – Qendra e Biznesit, Shkup, Maqedonia e Veriut, i cili merret me aktivitetet si; prodhimin e metaleve me ngjyra.

Yildirim Group ka një filiale të regjistruar në Kosovë **Yildrim Kosovo Mining Investment LLC**, e cila është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës të Kosovës, me seli në Rr. Ali Pashë Tepelena, Ivy Residence No.12b, Prishtinë, Kosovë, me numër të biznesit 811933002 e cila ka në pronësi **Newco Ferronikel Complex Shpk**, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, e regjistruar me numër të biznesit 810507444, me zyrë të regjistruar në adresën Drenas, e cila operon në sektorin e minierave, në prodhimin dhe furnizimin e ferronikelit.

Komercijalna Banka AD Shkup, është bankë tregtare me adresë të regjistruar në Vasil Ljoski nr. 3, Maqedonia e Veriut, i cila merret me shërbime të ndryshme bankare. Komercijalna Banka AD Shkup ka në pronësi asetete e synuara si pronat e paluajtshme dhe të luajtshme të kompanive:

Euronickel Industry Doo, ndërmarrje në falimentim, me adresë në Naseleno Mesto bez Ulicen Sistem, Vozarci, Maqedonia e Veriut

Nova Refraktori Doo, me adresë në Str. Industriska nr. 6, Pehcevo, Maqedonia e Veriut.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit: ka të bëjë me sektorin e minierave, duke përfshirë prodhimin dhe furnizimit me ferronikelit.

Tregu gjeografik: në transaksionin e propozuar është tregu i Republikës së Kosovës.

Analiza e konkurrencës:

Pas analizave të tregut lidhur me sektorin e minierave, përfshirë prodhimin dhe furnizimit me ferronikelit në Kosovë, konsiderojmë se, transaksioni i propozuar nuk do të çojë në ndonjë rritje të pjesës së tregut në Kosovë duke u nisur edhe nga fakti se të hyrat e krijuara nga Yildirim Group përmes NewCo Ferronikel në Kosovë bazohen në të hyrat nga eksporti i ferronikelit jashtë Kosovës për arsye se gjithë prodhimi i ferronikelit është i destinuar për tregun ndërkombëtar dhe mund të themi që konsumi kosovar i produkteve përkatëse në Kosovë është i papërfillshëm, ndërsa kompanitë të cilat janë target i këtij transaksioni nuk janë prezentë fare në Kosovë. Palët nuk kanë mbivendosje horizontale në Kosovë pasi që asnjë ka kompanitë e synuara nuk kanë operuar në asnjë formë në tregun përkatës të produkteve në prodhimin dhe furnizimin e ferronikelit dhe nënprodukteve të ferronikelit në Republikën e Kosovës. Ndërsa palët në këtë transaksion mund të kenë mbivendosje të kufizuar vertikale ndërmjet Filialit dhe Blerësit për arsye se: impianti zjarrdurues i blerë nga blerësi do të mbështesë furnizimin e kimikateve të ferronikelit dhe kromit, si dhe tullave zjarrduruese gjatë fazës së prodhimit të impianteve të ferronikelit në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ky proces përdoret për nevojat e brendshme të impianteve përkatëse të ferronikelit në pronësi të Filialit dhe Blerësit. Transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në tregun e Republikës së Kosovës pasi që, me këto produkte do të furnizohen palët e treta/klientët jashtë Kosovës, duke pas parasysh që kërkesa e konsumatorëve kosovarë për produktin përkatës është e papërfillshme.

Andaj, transaksioni si i tillë nuk ngrit shqetësimin për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se Pala Njoftuese në transaksionin e propozuar është prezentë në Kosovë përmes filialit e që ky i fundit ka në pronësi ndërmarrjen kosovare NewCo Ferronikel, ndërsa shoqëritë target nuk kanë asnjë aktivitet në Kosovë. Pala Njoftuese do të vazhdojë ta mbajë strukturën aktuale që ka në tregun e Republikës së Kosovës, pra transaksioni nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim në strukturën e tregut relevant në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese. Bazuar në sa më sipër, rezultojnë se transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës,

veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdataj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva